



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT

**NDËRTIM LERA PLASTMASI DHE KORITA BETONI
NË KULLOTË, “Qafa e Martës”.**

Fshati: Çemicë.

Njësia Adm.: Vithkuq.

Kodi kadastral: KO 31 036b, KO 31 039c.

Emri popullor i vendit: “Qafa e Martës”.

Ekonomia pyjore: Sherrë-Panarit.

Ngastra/Nënngastra: Nr. 36b, 39c.

PROJEKTOI:

Mikael Bedollari

Ledjan Ibro

Irisa Parangoni

Melsen Firanj

KONTROLLOI:

DREJTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Johan Marko

MIRATOI:

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO

MAJ 2026

1. KAPITULLI I: KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Përmbledhje e projektit.
- 1.2. Qëllimi i projektit.
- 1.3. Objektivat e Projektit.
- 1.4. Plan i punës.

2. KAPITULLI II: TË DHËNAT E OBJEKTIT

- 2.1. Vendosja gjeografike dhe administrative.
- 2.2. Kufijtë natyralë.
- 2.3. Sipërfaqja.
- 2.4. Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara.
- 2.5 Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia.
- 2.6 Kundrejtimi.
- 2.7 Lartësia mbi nivelin e detit.
- 2.8 Rrjeti hidrografik.
- 2.9 Përberja e bimesisë.
- 2.10 Kushtet klimatike.
- 2.11 Tokat.
- 2.12 Nevojat për ujë të pijshëm për blegtorinë.

3. KAPITULLI III: TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

- 3.1. Zgjedhja e vend ndërtimit të lerave dhe koritave.
- 3.2. Piketimi.
- 3.3. Gërmimet për hapjen e gropës.
- 3.4. Shtrimi i fletëve të plastmasit.
- 3.5. Vendosja e shtresës së dheut mbi plastmas.
- 3.6. Shtresa e kalldrëmit.

4. KAPITULLI IV: VLERESIMI I PROJEKTIT

- 4.1. Grafiku i punimeve.
- 4.2. Shpenzimet për realizimin e projektit.
- 4.3. Efektiviteti i veprës së ndërtuar.
- 4.4. Kuotimi për bazën materiale.
- 4.5. Analiza e riskut.

5. KAPITULLI V: ANEKSE

- 5.1. Foto satelitore e pozicionimit të objekteve.
- 5.2. Foto dixhitale të vendit ku do të ndërtohen objektet.
- 5.3. Harta e ngastrës, nënngastës.
- 5.4. Planvendosja e përgjithshme e lerave dhe koritave.

- 5.5. Planimetria e lerave.**
- 5.6. Prerje tërthore e lerave.**
- 5.7. Prerje gjatësore e lerave.**
- 5.8. Prerje tërthore tepërplotësi.**
- 5.9. Planimetria e koritave.**
- 5.10. Prerje tërthore e koritave.**
- 5.11. Prerje gjatësore koritave.**

KAPITULLI I

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1.1 Përmbledhje e projektit:

Do të realizohet projekti “Ndërtim lera plastmasi dhe korita betoni në kullotë ‘Qafa e Martës’ në Ekonominë Pyjore Sherrë-Panarit”, do të ndërtohen dy lera plastmasi me kapacitet ujëmbajtës 491 m³ secila, në nënngastrën nr. 36b dhe në nënngastrën nr. 39c, pjesë të Ekonomisë Pyjore Sherrë-Panarit dhe dy korita prej betoni përballë njëra tjetrës në nënngastrën nr. 39c në të njëjtën ekonomi, vendi ku propozohen ndërtimi i lerave dhe i koritave janë në pronësi të Bashkisë Korçë, në vëndin e quajtur me emrin popullor të nënngastrave “Qafa e Martës”, në afërsi të fshatit Çëmericë dhe Panarit në Njësinë Administrative Vithkuq.

1.2 Qëllimi i projektit:

Qëllimet e këtij projekti janë plotësimi i nevojave me ujë të pijshëm për blegtorinë që mbarështohet nga fermerët e fshatrave, Çëmericë, Panarit dhe Shtyllë, të cilët kontraktojnë këto kullota. Fermerët e këtyre fshatrave kanë traditë në mbarështimin e blegtorisë, por në këto zona mungojnë vendet ujore ujëmbajtëse të mirëfillta dhe si e tillë, mungesa e një vend grumbullimi të ujit të pijshëm për blegtorinë, sidomos gjatë periudhës së thatësirës në verë është bërë problem për blegtorët. Kërkesat e komunitetit për ndërtimin e veprave të reja ujëmbajtëse ka qenë e vazhdueshme. Realizimi i këtij investimi do të përmirësojë kushtet e mbarështimit të qëndrueshëm të blegtorisë. Gjithashtu impakt pozitiv do të ketë dhe në zbutjen e varfërisë, uljen e nivelit të papunësisë si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonës, nëpërmjet plotësimit të nevojave me produkte blegtoriale dhe shitjen e tyre në treg, njëkohësisht rrit kapacitetin kullosor, shfrytëzueshmërinë, bonitetin dhe efikasitetin ekonomik të këtyre kullotave. Realizimi i këtij projekti bëhet në zbatim të punimeve të përshkruara në Planin e Mbarështimit të ekonomisë pyjore EP-Sherrë-Panarit të miratuar.

1.3 Objektivat e Projektit:

Nëpërmjet projektit ndërtim lera plastmasi dhe korita betoni në kullotë do të realizohet:

- a. Do të ndërtohet lerë plastmasi me kapacitet ujëmbajtës 491 m³ dhe dy korita betoni përballë njëra tjetrës në nënngastrën nr. 39c të EP- Sherrë-Panarit në afërsi të fshatit Çëmericë dhe Panarit, në vëndin e quajtur “Qafa e Martës”.
- b. Do të ndërtohet lerë plastmasi me kapacitet ujëmbajtës 491 m³ në nënngastrën nr. 36b të EP-Sherrë-Panarit në afërsi të fshatit Çëmericë dhe Panarit.
- c. Ndërtimi i lerave dhe i koritave do të sigurojë ujin e pijshëm për bagëtitë dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen e produktivitetit të kullotës.
- d. Përmirësimin e shfrytëzueshmërisë së fondit kullosor.
- e. Në shtimin e numrit të bagëtive nga ana e fermerëve.
- f. Zgjatjen e periudhës së kullotjes.
- g. Shtimin e produkteve blegtoriale.
- h. Zbatimin e udhëzimeve të punimeve të parashikuara në planin e mbarështimit të ekonomisë.

- i. Uljen e nivelit të papunësisë dhe përmirësimin e nivelit ekonomik të banorëve të zonës.
- j. Ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e fondit pyjor/kullosor.
- k. Në rast zjarri në fondin pyjor/kullosor në afërsi të saj, uji mund të përdoret dhe për fikjen e tij.

1.4 Plani i punës:

Realizimi i këtij projekti do të kryhet me fondet e Bashkisë Korçë. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, grupi i punës në Bashkinë Korçë, do të realizojë projektin për ta vënë në zbatim për realizimin e punimeve.

Do të ndërtohet një lerë plastmasi me kapacitet ujëmbajtës 491 m³ dhe dy korita betoni përballë njëra tjetrës në nënngastrën nr. 39c të EP- Sherrë-Panarit në afërsi të fshatit Çëmericë dhe Panarit si dhe lerë plastmasi me kapacitet ujëmbajtës 491 m³, në nënngastrën 36b, të kësaj ekonomie.

Plani i Punës në formë tabelare.

Plani i punës	Manaxhimi i Projektit	Afati
Objektivi	Ndërtimi i lerave dhe i koritave dhe sigurimi i nevojave për ujë të pijshëm për blegtorinë e zonës.	3 muaj
Financimi	Bashkia Korçë.	3 muaj
Detyrat	D.1.1. Piketimi sipas specifikimeve të projektit.	Para fillimit të punimeve
	D.1.2. Sigurimi dhe transporti i bazës materiale të nevojshme nga subjekti.	2 muaj
	D.1.3. Punimet e gërmimit për hapjen e gropës sipas përmasave të përcaktuara në projekt, mbushja, rafshimi, ngjeshje, prodhimi i gurrëve, hedhje dheu dhe betoni, transport dheu dhe gurrësh, Shtrimi dhe lidhja e shtresave të plastmasit, dheut, kalldremit, etj.	3 muaj
	D.1.4. Monitorimi dhe kontrolli i punimeve, nga mbikqyrësi, etj.	Gjatë gjithë periudhës së kryerjes së punimeve
	D.1.5. Përfundimi i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës.	Gjatë dhe pas përfundimit të punimeve
	D. 1.6. Marrja në dorëzim e punimeve.	Pas përfundimit të punimeve
Rezultatet e pritshme	Ndërtimi me sukses i lerave dhe koritave sipas preventivave dhe specifikimeve përkatëse, në mënyrë që të realizohet efikasiteti i saj duke bërë të mundur mbajtjen e ujit gjatë sezonit veror, me qëllimin për të siguruar ujë për blegtorinë. Kjo gjë do të ndikojë në rritjen e rendimentit të prodhimeve blegtorale, shtimin e numrit të krerëve me bagëti që mbarështojnë fermerët e zonës, përmirësimin e kushteve ekonomike të komunitetit, vënien në zbatim të planit të mbarështimit të ekonomisë.	

KAPITULLI II

2. TË DHËNAT E OBJEKTIT

2.1 Vendosja gjeografike dhe administrative:

Objektet për ndërtimin e njërës prej lerave dhe koritat bëjnë pjesë në Ekonominë Pyjore Sherrë-Panarit, në nënngastrën 39c dhe një lerë bën pjesë në nënngastrën 36b, në afërsi të fshatrave Çemericë dhe Panarit, në Njësinë Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë.

2.2 Kufijtë natyralë:

Objekti i planifikuar për ndërtim lere dhe korita në nënngastrën 39c kufizohet:

Nga veriu kufizohet me nënngastrën 40c dhe 40f të EP-Sherrë-Panarit.

Nga jugu kufizohet me nënngastrën 38c të EP-Sherrë-Panarit.

Nga lindja kufizohet me nënngastrën 39b të EP-Sherrë-Panarit.

Nga perëndimi kufizohet me Bashkinë Skrapar.

Objekti i planifikuar për ndërtim lere në nënngastrën 36b kufizohet:

Nga veriu kufizohet me nënngastrën 37c të EP-Sherrë-Panarit.

Nga jugu kufizohet me EK- Sherrë-Panarit.

Nga lindja kufizohet me nënngastrën 36a të EP-Sherrë-Panarit.

Nga perëndimi kufizohet me EK- Sherrë-Panarit, Bashkinë Skrapar.

2.3 Sipërfaqja:

Nënngastra nr. 39c e ekonomisë pyjore Sherrë-Panarit ka një sipërfaqe prej 174.06 ha dhe nënngastra nr. 36b e ekonomisë pyjore Sherrë-Panarit ka një sipërfaqe prej 8.46 ha, të cilat shfrytëzohen për kullotje gjatë periudhës së vegjetacionit nga fermerët e zonës.

2.4 Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:

Objektet për ndërtimin e lerës dhe koritave në nënngastrën 39c kanë një distancë të afërt me njëra tjetrën, përshkohen nga rruga auto pyjore. Distanca nga objekti i ndërtimit të lerës në nënngastrën 36b me qendrën e Njësisë Administrative Vithkuq është 18 km, si dhe nga qendra e Bashkisë Korçë është rreth 45 km, fshati më i afërt është Çemericë dhe Panariti ndërsa distanca e objektit të ndërtimit të lerës dhe koritave në objektin e ndërtimit në nënngastrën 39c me qendrën e Njësisë Administrative Vithkuq është 19 km, si dhe nga qendra e Bashkisë Korçë është rreth 46 km dhe fshati më i afërt është Çemericë dhe Panariti.

2.5 Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia:

Forma e relievit ku do të ndërtohet lera në ngastrën 36b është shpat, terren pak a shumë i pjerrët, me pjerrësi 11-40% vendi i ndërtimit të lerës është në vendin ku gravitojnë rrjedhjet e reshjeve atmosferike dhe ku furnizohet nga rrjedha ujore.

Forma e rielievit ku do të ndërtohet lera dhe koritat në ngastrën 39c është shpat, terren shumë i pjerrët, me pjerrësi 41-70%, vendi i ndërtimit të lerës është në vendin ku gravitojnë rrjedhjet e reshjeve atmosferike dhe ku furnizohet nga rrjedha ujore si dhe vendi i ndërtimit të koritave është vend ku burojnë rrjedha ujore të cilat do të furnizojnë koritat me ujë.

2.6 Kundrejtimi:

Objektet në nënngastrën 39c kanë kundrejtim jug-lindor dhe objekti në nënngastrën 36b ka kundrejtim veri-lindor.

2.7 Lartësia mbi nivelin e detit:

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e vendit në vendin ku do të ndërtohet lera dhe koritat në nënngastrën 39c është 1950 m, ndërsa në vendin ku do të ndërtohet lera në nënngastrën 36b është 1813 m.

2.8 Rrjeti hidrografik:

Kjo ekonomi mund të klasifikohet si e pasur nga ana hidrologjike, përshkohet nga disa përrenj dhe afluentet e tyre. Këto prroska furnizohen me ujë nga burime të shterrshme dhe të pashterrshme dhe nga reshjet atmosferike. Nga burimet e pashterrshme dhe të konsiderueshme mund të përmendim, burimi i qafë Martës.

Objekti në nënngastrën 39c ka rrjedha ujore dhe burime uji të cilat do të shfrytëzohen për të furnizuar lerën dhe koritat me ujë për mbushjen e tyre, si dhe objekti në nënngastrën 36b, ka rrjedha ujore të cilat do të shfrytëzohen për të furnizuar lerën me ujë për mbushjen e saj dhe mbajtjen e ujit përgjatë periudhës së thatësisë.

2.9 Përbërja e bimësisë:

E gjithë sipërfaqja në nënngastrën 39c shfrytëzohet si kullotë, me gradë veshje rreth 40 % e përbërë nga bimë të familjes graminaceae, 30 % është leguminoze dhe 30 % të tjera, me koeficient ngrënshmërie të lartë dhe në objekti në nënngastrën 36b, përbërja është 50 % e përbërë nga bimë të familjes graminaceae, 30 % është leguminoze dhe 20 % të tjera. Në tërësinë e ekonomisë pyjore hasen disa lloje të bimeve me vlera mjeksore, aromatike apo ushqimore.

2.10 Kushtet klimatike:

Objektet në ekonominë pyjore Sherrë – Panarit shtrihen në zonën mesdhetare kontinentale malore juglindore. Temperaturat mesatare vjetore janë 15 – 16 gradë Celsius, minimalet vjetore janë 0 - 3 gradë Celsius, maksimalet 32 – 35 gradë Celsius. Sasia e reshjeve që bien në këtë ekonomi variojnë nga 860 – 1050 mm në vit. Në këtë ekonomi bien dhe reshje dëbore që zakonisht fillojnë nga fillimi i dhjetorit deri në fund të marsit dhe trashësia e dëborës arrin nga 20 – 80 cm në raste të veçanta dhe më shume duke arritur deri 1 m, sidomos në pjesën e sipërme të ekonomisë. Reshjet më të shumta bien në pranverë dhe në vjeshtë, në pjesën e sipërme të ekonomisë ka reshje të shpeshta me frekuencë të vogël dhe gjatë verës, në disa raste në formë bresheri.

Vegjetacioni në këtë ekonomi zgjat nga fundi i marsit fillimi i prillit deri në fundin e tetorit. Ngricat e hershme mund të ndodhin që në fund të nëntorit dhe në raste të rralla dhe më heret dhe ngricat e vonshme në mes të Prillit dhe në raste të rralla dhe më vonë.

2.11 Tokat:

Objektet që do të ndërtohet shtrihen mbi toka livadhore-malore. Thellësia e tokës është 31-60cm. Janë toka me strukturë, të freskëta dhe shumë pak të thata me reaksion dominues neutral.

2.12 Nevojat për ujë të pijshëm për blegtorinë:

Në zonën rreth objektit të planifikuar për ndërtimin e lerës dhe të koritës, kullosin bagëtitë e fshatrave Çemicë, Panarit dhe Shtyllë. Kullota shfrytëzohet vetëm gjatë muajve të verës dhe mungesa e vendeve të grumbullimit të ujit të pijshëm për bagëtitë zvogëlon numrin e diteve në kullotë për shkak të mungesës së tyre. Në këtë zonë ka disa burime ujore dhe rrjedha ujore natyrore por blegtorët hasin mjaft vështirësi në sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë. Aktualisht barinjtë e kanë të vështirë ti përdorin këto rrjedha si pasojë e mos grumbullimit në një vend të tyre në mënyrë që bagëtitë të pijnë ujë, por ato janë të pamjaftueshme dhe thahen gjatë periudhës së verës kur është dhe periudha më e nevojshme në mënyrë që bagëtitë të pijnë ujë dhe në periudhën e thatësirës kur prurjet e ujit zvogëlohen ndjeshëm ose dhe thahen në pjesë të tyre gjë që mund të bëhet shkak për shkurtimin e periudhës së kullotjes dhe uljen e rendimentit të prodhimeve blegtorale, kufizon shfrytëzimin e kullotës dhe shtimin e numrit të bagëtive nga fermerët e fshatrave. Sigurimi i ujit të pijshëm me anë të ndërtimit të lerave dhe koritave do ndikojë në përmirësimin e kushteve të blegtorisë dhe shtimin e rendimentit të prodhimit, si dhe funksionalitetin e kullotës, dhe krijimin e habitateve të reja.

KAPITULLI III

3. TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

3.1 Zgjedhja e vendit për ndërtimin e lerave dhe koritave:

Zgjedhja e vend ndërtimit të lerave me plastmas dhe koritave të betonit dikton disa veçori që kushtëzohen nga vetë natyra e terrenit dhe konstruksioni i këtyre veprave. Për përcaktimin e vendit të ndërtimit preferohen terrenet që tradicionalisht janë vend grumbullime të rrjedhjeve që kanë shërbyer natyrshëm për pirjen e ujit në një periudhë të shkurtër nga tufat e bagëtive. Në mungesë të tyre zgjidhen dhe përcaktohen vende të rrafshëta, qendra gravitale të rrjedhave dhe të bazenit ku toka është e përshtatëshme dhe pa shkëmbinj nëntokësor.

Vendi i ndërtimit të lerave dhe koritave është vendosur pothuajse në qendrën gravitacionale të kullotës, në vendin me optimal të grumbullimit të reshjeve që bien në territorin e kullotës dhe në rrugën më të përshtatëshme të kalimit të blegtorisë sidomos për të pirë ujë. Nga verifikimi në vend i lerës në nënngastrën 39c, rezulton se gjatë vitit sidomos në periudha reshjesh kalojnë disa rrjedha ujore e cila është zgjedhur të ndërtohet në një vend grumbullimi me ujë, e cila e krijon atë gjatë shkrirjes së dëborës, gjatë muajve Maj-Qershor. Si dhe në vendin ku do të ndërtohen dy koritat në nënngastrën 39c përballë njëra tjetrës ekziston një burim i cili do të shërbejë për të kryer funksionin e furnizimit të koritave dhe mbajtjes së ujit përgjatë gjithë vitit dhe sidomos gjatë periudhave të kullotjes së bagëtive. Si dhe në lerën e propozuar për ndërtim në nënngastrën 36b është zgjedhur të ndërtohet në një vend grumbullimi me ujë ku kalojnë disa rrjedha ujore.

3.2 Piketimi

Gjatë piketimit duhet të mbahen në konsideratë përmasat e lerave. Në skicën e lerave janë të përcaktuara përmasat e lerave mbas ndërtimit të tyre. Mbi këtë bazë janë bërë dhe llogaritjet e volumit të germimit dhe të kapacitetit ujëmbajtës, prandaj gjatë piketimit perimetrat për të dyja lerat do kenë diametra si më poshtë: diametri i madh do të jetë 20 m, diametri i vogël do të jetë 10 m, ndërsa thellësia e lerave do të jetë 2.5 m. Në periferi të gropës piketohet dhe oborri (trotuari) i lerave i cili është i gjerë 1.2 m. Forma e lerave do jetë rrethore. Do të ndërtohet tepërplotësi, që do të shërbejë për shkarkimin e tepërcave të ujit.

Gjatë piketimit të koritës duhet të mbahen në konsideratë përmasat e saj. Korita do të jetë njëra 30 m e gjatë dhe tjetra 25 m duke filluar nga burimi më pas shtrihet në të dy krahët. Koritat do të furnizohen me ujë me tubo të cilat do të shërbejnë për ti mbushur ato me ujë gjatësia e tyre do të jetë nga 70 m për secilin krah, në fund të koritës janë parashikuar të vendosen dhe tuba me tapa të cilat do të shërbejnë për pastrimin e koritës nga mbeturinat. Për ndërtimin e koritës në fillim do të germohet një thellësi prej 0.1 m e cila do të mbushet me çakull ose zhavor më pas do të vendoset zgara e hekurit me Ø 8, (10 x 10) cm dhe do hidhet betoni M-300, do të përdoret beton i kësaj marke pasi duke qënë se korita ndodhet në lartësinë 1900 m mbi nivelin e detit periudha e dimrit është me temperatura nën zero.

Përmasat, kuotat e lerës dhe koritës janë të saktësuara në skicat bashkëngjitur projektit.

3.3 Gërmimet për hapjen e gropës

Gërmimi fillon pasi janë bërë piketimet e nevojshme sipas kuotave dhe skicë-projektit. Në fillim realizohen punimet e gërmimit duke sjellë dhe formën e lerave dhe të koritave. Pastaj gërmohet në perimetrin e vogël të tabanit të lerave, vazhdohet paralelisht me formimin e skarpatës duke respektuar diametrin e madh diametrin e vogël dhe thellësinë e lerës. Dheu i shtresës së sipërme largohet me ekskavator në një largësi mbi 20 m nga periferia e lerës. Dheu i shtresave pasardhëse gjithashtu transportohet me karrocë dore larg lerave, por një pjesë e tij që ka përmbajtje argjilore më të lartë dhe është i pastër nga prania e gurëve dhe mbeturinave, grumbullohet togje - togje rreth periferisë së lerës për t'u përdorur më vonë për bërjen e shtresave për vendosjen e plastmasit. Me gërmimet mbaron edhe procesi i rrafshimit të skarpatave, uniformizimit dhe pastrimit nga çdo trup i huaj e gurë.

Për ndërtimin e koritës në fillim do të gërmohet një thellësi prej 0.1 m e cila do të mbushet me zhavor ose çakëll, më pas do të vendoset zgara e hekurit me Ø 8, 10 x 10 dhe do hidhet beton M-300.

3.4 Shtrimi i fletëve të plastmasit

Para se të fillojë shtrimi i plastmasit të lerave shtrohet një shtrese dheu të situr me trashësi 20 cm e cila ngjishet me tokmak duke filluar nga aksi diametrik i lerës deri tek perimetri i trotuarit. Janë parashikuar të shtrohen dy shtresa plastmasi. Për formimin e tegeleve të palosjeve, buzët e fletëve të plastmasit mbivendosen në një hapësirë 40 cm. Tegelet e palosjeve do të kenë një gjërësi maksimale 8 cm, që do të thotë se parashikohen 5 palosje për formimin e tegelit. Pas përfundimit të palosjeve të çdo tegeli, mbi të vendosen gurë pllakatorë e me sipërfaqe të lëmuar, për t'i mbajtur ata në gjendje të qëndrueshme. Me përfundimin e këtij procesi, bëhet një kontroll i vëmendshëm përfundimtar për të parë ndonjë shmangie ose çrregullim të rastësishëm. Ky proces bëhet me teper kujdes nga punëtorët për të mos u rrezikuar çarja e fletëve të plastmasit.

3.5 Vendosja e shtresës së dheut mbi plastmas

Dheu që do të përdoret për shtresën mbi plastmas duhet të jetë i situr në shoshë me vrima 2 x 2 cm në mënyrë që të pastrohet nga guralecët e pranishëm apo mbeturina të tjera. Formimi i shtresës së dheut (20 cm trashësi) bëhet duke filluar nga tabani i lerave deri në periferinë e oborrit. Transporti i tij bëhet me karrocë dore. Ngjeshja e dheut bëhet me tokmak në prani të një lagështie të favorshme ngjeshjeje. Gjatë formimit të shtresës së dheut hap pas hapi hiqen edhe gurët që janë vendosur përgjatë tegeleve të palosjeve dhe nxirren jashtë me karrocë dore. Në periferinë e trotuarit të lerës bëhet një kanal me seksion tërthor 20 x 20 cm, ku futen mbarimet e fletëve të plastmasit dhe përgjatë tij, mbi fletë vihen gurë, me qëllim që t'i fiksojnë ato. Shtresa e dheut pas përfundimit të ngjeshjes duhet të jetë 20 cm.

3.6 Shtresa e kalldrëmit

Shtresa e kalldrëmit aplikohet në sipërfaqen e lerave dhe të trotuarit. Trashësia e kalldrëmit është parashikuar 20 cm. Kalldrëmi duhet të jetë kompakt, gurët nuk duhet të lëvizin kur mbi ta ushtrohet pesha trupore dhe boshllëqet midis gurëve do të mbushen me gurë të vegjël të coptuar me çekan. Gurët për ndërtimin e lerave do të prodhohen dhe transportohen në afërsi të vendit ku ndodhen lerat.

KAPITULLI IV

4. VLERESIMI I PROJEKTIT

4.1 Grafiku i punimeve

Punimet për ndërtimin e Lerave dhe Koritave, fillojnë mbas lidhjes së kontratës. Për punimet e gërmimit, mund të punohet gjatë gjithë periudhës së punimeve, Për shoshitjen e dheut, krijimin e shtresës prej 20 cm me dhe, dhe shtresës prej 20 cm kalldrëm duhet të punohet në ditë pa reshje. Gjatë monitorimit nga ana e drejtuesit teknik të punimeve, mbikqyrësit dhe mbikëqyrësit të kontratës do të ndiqen me përparësi treguesit: Zbatimi i përmasave të gropës, cilësia e punimeve për rrafshimin e skarpatave dhe pastrimit nga gurët, palosja (bashkimi) i shtresave të plastmasit, trashësia dhe ngjeshja e shtresës së dheut dhe kalldrëmit mbi plastmas.

GRAFIKU I PUNIMEVE

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	MUAJI		
I		Ndërtim Lere Plastmasi "Qafa e Martës", nënngastra 36b.			I	II	III
1	1-13.4	Gërmim dheu me krahë, në tokë mesatare, në seksion të lirë, kategoria e III dhe transport me karro dore deri 10 m	m3	1500			
2	1-13.36-b	Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak, me krahë, çdo 20 cm, në tokë të zakonshme.	m3	180			
3	1-13.37-b	Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gërmim, në tokë të zakonshme	m2	140			
4	1-13.72-b	Prodhim gurësh me krahë, kur në sipërfaqje ka mesatarisht gurë	m3	114			
5	1-13.39-a	Hedhje dheu me lopatë, në tokë të butë	m3	450			
6	1-13.69	Përgatitje me krahë e betonit M-300	m3	1.2			
7	1-13.71	Hedhje betoni me krahë	m3	1.2			

8	1-13.65-b	Transport zhavorri, çakulli me kafshë, në distancë 0.5-1 km	m3	1.2			
9	1-13.44	Shoshitje dheu (shosha me vrima 2 x 2 cm)	m3	90			
10	1-13.55	Transport dheu me karro dore, në distancë deri 10 ml	m3	90			
11	1-13.56	Transport gurësh me karro dore, në distancë deri 10 ml	m3	90			
12	1-13.75-b	Shtresë kalldrëmi me gurë kave, me trashësi 20 cm.	m2	450			
13	1-13.45	Shttrim plastmasi me dy shtresa, formimi i tegelit me 5 palosje (gjerësi 6-8 cm per çdo palosje) dhe fiksimi i tij me mjete rrethanore	m2	1300			
14	1-13.63-b	Transport gurësh me kafshë, në distancë 0.5 - 1 km	m3	90			
II		Ndërtim Lere Plastmasi "Qafa e Martës", nënngastra 39c.			I	II	III
1	1-13.4	Gërmim dheu me krahë, në tokë mesatare, në seksion të lirë, kategoria e III dhe transport me karro dore deri 10 m	m3	1600			
2	1-13.36-b	Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak, me krahë, çdo 20 cm, në tokë të zakonshme.	m3	180			
3	1-13.37-b	Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gërmim, në tokë të zakonshme	m2	140			
4	1-13.72-b	Prodhim gurësh me krahë, kur në sipërfaqje ka mesatarisht gurë	m3	114			
5	1-13.39-a	Hedhje dheu me lopatë, në tokë të butë	m3	450			
6	1-13.69	Përgatitje me krahë e betonit M-300	m3	1.2			
7	1-13.71	Hedhje betoni me krahë	m3	1.2			
8	1-13.65-b	Transport zhavorri, çakulli me kafshë, në distancë 0.5-1 km	m3	1.2			
9	1-13.44	Shoshitje dheu (shosha me vrima 2 x 2 cm)	m3	90			
10	1-13.55	Transport dheu me karro dore, në distancë deri 10 ml	m3	90			
11	1-13.56	Transport gurësh me karro dore, në distancë deri 10 ml	m3	90			
12	1-13.75-b	Shtresë kalldrëmi me gurë kave, me trashësi 20 cm.	m2	450			

13	1-13.45	Shtrim plastmasi me dy shtresa, formimi i tegelit me 5 palosje (gjeresi 6-8 cm per çdo palosje) dhe fiksimi i tij me mjete rrethore	m2	1300			
14	1-13.63-b	Transport gurësh me kafshë, në distancë 0.5 - 1 km	m3	90			
III		Ndërtim Korita "Qafa e Martës", nënngastra 39c			I	II	III
1	1-13.4	Gërmim dheu me krahë, në tokë mesatare, në seksion të lirë, kategoria e III dhe transport me karro dore deri 10 m	m3	50			
2	1-13.36-b	Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak, me krahë, çdo 20 cm, në tokë të zakonshme.	m3	5			
3	1-13.85	Ndërtim pusete prej betoni (për 1 m3 beton) M-300, ku perfshihen ndërtimi armaturës prej druri, vendosja e hekurit ose rrjetës prej teli, përgatitja e betonit, betonimi dhe dizarmimi	m3	16			
4	An_3	Tube plastike d = 50 m/m	ml	145			

4.2 Shpenzimet për realizimin e projektit

Për realizimin e punimeve të planifikuara në këtë projekt, çmimet për njësi, janë bazuar në V.K.M nr. 839, datë 30.12.2025 “Për miratimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve”, VKM. Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” janë hartuar preventivat përkatës të lerave dhe koritave së bashku.

4.3 Efektiviteti i veprës së ndërtuar:

Pas ndërtimit të lerave dhe koritave, sigurimi i ujit do të mundësojë një qëndrim të blegtorisë më të gjatë në kullotë, përdoruesit e kullotës do të përfitojnë pasi do të sigurnë ujë të pandërprerë gjatë periudhës së kullotjes së bagëtive, do rritet numri i krerëve të bagëtive që mbarështojnë si dhe rendimenti/krerë, duke shtuar prodhimet blegtorale për konsum dhe për treg, çfarë do ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Lerat do të jetë në gjendje të mbajë 491 m³ ujë secila. Koha e kullotjes dhe e qëndrimit të bagëtive do të jetë mbi 5 muaj dhe numri i tyre do të rritet. Të ardhurat direkte që rezultojnë pas kryerjes së punimeve konsistojnë në shtesën e vlerës tarifore të kullotjes për sezon. Punëtorët për ndërtimin e lerave dhe koritave do përfitojnë ekonomikisht si rezultat i pagesës për punimet e kryera. Nëpërmjet investimit synohet dhe të sensibilizohet komuniteti për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor, si dhe përmushja e objektivave të planit të mbarështimit të ekonomisë.

4.4 Kuotimi për bazën materiale

Për realizimin e punimeve të planifikuara në këtë projekt, çmimet për njësi, janë bazuar në V.K.M nr. 839, datë 30.12.2025 “Për miratimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve”, VKM. nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Në preventiva, në emertimin e punimeve përfshihen punime në ndërtimin e lerave si germim dheu, rafshim skarpate, prodhim gur kave, shoshitje dheu, transport dheu me karrocë dore, hedhje, rafshim, ngjeshje dheu me tomak, shtrim plastmasi, transport guri me karrocë, shtrim kalldrëmi, mur guri themele, brez betoni, transport gurrësh muri, punime për shkarkues si germim e transport dheu, tubo plastike, shtresë zhavori, çakëlli , beton kaptazhi dhe shkarkues, punime në ndërtimin e koritës, germim e transport dheu, shtresë zhavori ose çakull, tubo plastike, beton për koritën, zgarë hekuri, tapa shpëlarje.

4.5 Analiza e riskut

Për arritjen e objektivave të parashikuar mund të paraqiten vështirësi si largësia e objekteve nga qendrat e banuara. Vështirësi për transportin e materialeve, pasi rruga auto është në gjendje të keqe. Këto punime duhet të kryhen deri në muajt tetor-nëntor sepse më vonë nuk ka garanci për tu realizuar për shkak të kushteve të jo të mira atmosferike. Duhet të merren masa dhe të punohet me shumë kujdes në shtrimin e plastmasit të lerës dhe ruajtjen e tij që të mos çahet nga gurët, nga bagëtitë ose për shkaqe të tjera, dhe uji të depërtojë dhe të futet poshtë tij, duke sjellë kështu që uji mos të qëndrojë lart, sidomos gjatë muajve të sezonit veror, gjatë thatësirës ku nevojitet më shumë. Duhet të forcohen mirë kalldrëmi nga shëmbjet dhe aluvionet.

KAPITULLI V


1. Aneke

5.1 Foto satelitore e pozicionimit të objekteve.

Pamje nga lart e vendit ku do të ndërtohet lera në objektin në nënngastrën 36b.



Pamje nga lart e vendit ku do të ndërtohen lera dhe koritat në objektin në nënngastrën 39c.



5.2 Foto dixhitale të vendit ku do të ndërtohen objektet.

Pamje të vendit ku do të ndërtohet lera në objektin në nënngastrën 36b.



Pamje të vendit ku do të ndërtohet lera në objektin në nënngastrën 39c.




Pamje të vendit ku do të ndërtohen koritat në objektin në nënngastrën 39c.




5.3 Harta e ngastrës, nënngastrës.


Pamje e përgjithshme e ekonomisë pyjore Sherrë-Panarit, ku do të ndërtohen lerat dhe koritat.




Pamje të nënngastrës 36b, ku do të ndërtohet lera.




Pamje të nënngastrës 39c, ku do të ndërtohet lera dhe koritat.




5.4 Planvendosja e përgjithshme e lerave dhe koritave.
Planvendosja e përgjithshme e lerës në nënngastrën 36b.




Planvendosja e përgjithshme e lerës dhe koritave në nënngastrën 39c.



Planimetria e lerës në nënngastrën 36b.



Planimetria e lerës në nënngastrën 39c.




5.6 Prerje tërthore e lerave.

Prerje tërthore e lerës në nënngastrën 36b.




Prerje tërthore e lerës në nënngastrën 39c.




5.7 Prerje gjatësore e lerave.

Prerje gjatësore e lerës në nënngastrën 36b.




Prerje gjatësore e lerës në nënngastrën 39c.



5.8 Prerje tërthore tepërplotësi


PRERJE TËRTHORE TEPËRPLOTESI




5.9 Planimetria e koritave.

Planimetria e koritave në nënngastrën 39c.

PLANIMETRIA E KORITAVE






5.10 Prerje tërthore e koritave.



5.11 Prerje gjatësore e koritave.

PRERJE GJATESORE E KORITAVE



PRERJE GJATESORE E KORITAVE

